



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes urgjente të Kuvendit të Komunës, mbajtur më 10.04.2020, e cila filloi në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Adrian Berisha (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Valbona Petrovci (e pavarur), Leonora Shabani – Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna – Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (e pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (i pavarur) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Haki Dragusha (LDK), Elmire Nikçi – Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Nol Nushi (PSD), Naim Hoxha (LVV), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Migjen Shala (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, dhe përfaqësues të medieve elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit, i cili propozoi këtë

R E N D D I T E:

- 1. Propozimvendimi për aprovimin e pakos emergjente ekonomike me rastin e Covid- 19;**
- 2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2019 në vitin 2020.**

Pika e parë

Propozimvendimi për aprovimin e pakos emergjente ekonomike me rastin e Covid- 19.

Kryetari, Shpend Ahmeti, tha se ne deri më sot kemi 26 raste të konfirmuara me Covid- 19 në Prishtinë, por kemi arritur ta evitojmë një shpërthim të rëndë. Qëllimi është që këto raste t'i zvogëlojmë për aq sa është e mundur, andaj nevojitet vendim i qartë për çdo komunë dhe ne do të vazhdojmë me masa restriktive. Po ashtu, do të kemi disa risi në arsim gjatë javëve në vijim, me mësim shtesë për komunën e Prishtinës, për disa gjëra të cilat i kemi përgatitur me inkuadrim më të madh të prindërve në qeverisjen e shkollave dhe në informimin për nxënësit e tyre, ku për këtë do t'ju informojmë me kohë në Kuvend.

Ne e kemi përgatitur një pako emergjente, të cilën po e quajmë "Prishtina 1", duke e marrë parasysh se mund të kemi nevojë edhe për pakon "Prishtina 2", në çoftë se situata vazhdon si e tillë, prandaj sot do t'i prezantoj në mënyrë të shkurtër këto 14 pika që i kemi përgatitur, të cilat do të na ndihmojnë tepër shumë si ekzekutiv për ta bërë punën tonë që ta luftojmë këtë virus së bashku.

Kjo pako emergjente ekonomike përfshinë:

- 1. Sigurimi i 5000 pakove higjienike, në vlerë prej 50,000 €;**
- 2. Sigurimi i 5000 pakove ushqimore, në vlerë prej 150,000 €;**
- 3. Pajisje shëndetësore, në vlerë prej 200,000 €;**
- 4. Buxhet për dezinfektim – deri në 200,000 €;**
- 5. Të gjitha bizneset të cilat janë me qira në lokalet të cilat janë pronë e ndërmarrjeve publike lokale të Prishtinës, do të lirohen nga qiraja nga dita kur kanë filluar masat restriktive, për dy muaj rresht, për pjesën që nuk mbulohet nga Qeveria (pakoja ekonomike);**
- 6. Të gjitha bizneset e gastronomisë, të cilat paguajnë taksë për shfrytëzimin e hapësirës publike, lirohen nga pagesa për një vit (një sezon veror dhe një dimëror);**

7. NPL "Stacioni i Autobusëve" do të subvencionohet për pagat e muajit prill, në vlerë prej 80,000 euro;
8. Çerdhet do të subvencionohen për pagat e punëtorëve, kostoja e të cilave është 50 mijë euro në muaj;
9. Lirohen nga pagesa të gjithë prindërit e fëmijëve që shfrytëzojnë çerdhet publike për periudhën që qëndrojnë çerdhet e mbyllura;
10. NPL "Prishtina Parking" subvencionohet me 50 mijë €;
11. Subvencione për sport, në vlerë prej 100,000 €, për klubet në vështirësi për shkak të mosfunksionimit të garave;
12. Subvencione për kulturë, në vlerë prej 100,000 €, për artistët të cilët nuk kanë të hyra si pasojë e pandemisë Covid- 19;
13. "Trafiku Urban", "Hortikultura", "Sport Marketing" dhe "Pastrimi", do të subvencionohen pas vlerësimit të nevojës deri në fund të muajit prill;
14. Do të themelohet një program i granteve për biznese, të vetëpunësuarit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, i cili do të ndihmojë bizneset që dëshmojnë humbjet nga masat restriktive.

Kryesuesi kërkoi nga të pranishmit që, për hir të funksionimit më të mirë, diskutimi të bëhet për dy pikat për njëherë, pastaj votimi të bëhet ndaras.

Visare Gorani propozoi që në pakot higjienike të shtohen edhe artikuj të tjerë higjienik dhe sanitar.

Halim Halimi propozoi që në këtë shpërndarje të ndihmave, pako shëndetësore, higjienike, të përfshihen edhe bashkësitë lokale, të kontaktohen udhëheqësit e BL-ve.

Egzon Azemi tha se duke pasur parasysh gjendjen e krijuar, propozoj që mbledhjet e Kuvendit të mbahen në formën online, madje aty mund t'i bëjmë edhe diskutimet me shkrim, por edhe votimet në mënyrë online.

Sami Boroci tha se kjo është një pako e mirë për tejkalimin e kësaj krize, por do të ishte mirë që vlera e saj të rritet, andaj propozoj që në nenin II, pika 2 e këtij vendimi, vlera e pakos prej 30 eurove të rritet në 40 euro. Po ashtu, duhet të ndihmohen edhe ndërmarrjet publike, meqë kanë pasur probleme me të hyra.

Shefki Gashi tha se vlera prej 30 eurove për një pako është e vogël, andaj do të ishte mirë që kjo vlerë të rritet. Por, masat për siguri gjithsesi duhet të zbatohen.

Leutrim Retkoceri theksoi se sa i përket pikës së parë, që ka të bëjë me pakot higjienike, propozoj që kjo pako të shtohet në sasi, pra shuma prej 50,00 euro të jetë në 100,000 euro. Po ashtu, propozoj që kompanisë "Pastrimi" t'i ndahet një shumë e mjeteve si ndihmë, dhe t'i kërkohet që grumbullimin e mbeturinave ta bëjë edhe më shpesh.

Gjithashtu, kërkoj që të merren masa sa më të shpejta për renovimin e tualeteve nëpër shkollat fillore dhe të mesme në Prishtinë.

Shefqet Osmani kërkoi nga ekzekutivi që t'i ndihmohet me mjete financiare një familjari në fshatin Lebanë, të cilit i është djegur shtëpia.

Vlora Dumoshi tha se vlera e pakos prej 30 euro për personat që janë në asistencë sociale është e pamjaftueshme, andaj kërkoj që kjo vlerë të rritet.

Arbër Vokri kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, të qartësojë se për sa kohë kanë me u ndarë këto mjete, jo vetëm atë të Urgjencës, por edhe të Mjekësisë Familjare me pajisje mbrojtëse, do të thotë me maska dhe doreza, e sipas mundësive edhe mburojat e fytyrës dhe veshje.

Adrian Berisha tha se do të kishte qenë mirë që, për herë të parë të jetë i kyçur në shpërndarjen e këtyre subvencioneve edhe Komiteti për Arsim, Kulturë dhe Sport.

Nazlie Bala kërkoj nga kryetari i Komunës që të bëhet dezinfektimi i hapësirave edhe në lagjet e tjera, siç janë: "Taslixhja", "Arbëria", "Bregu i Diellit", "Kolovica", pra të shtrihet dezinfektimin në secilën lagje të Prishtinës.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës.

Me propozimin që pika 1 e nenit II të vendimit, (vlera e mjeteve prej 50.000 euro), rritet në 100.000 euro, dhe pika 2 (vlera e mjeteve prej 150.000 euro) rritet në 200.000 euro, kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për aprovimin e pakos emergjente ekonomike me rastin e Covid- 19.

Pika e dytë

Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2019 në vitin 2020.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2019 në vitin 2020.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta**

